

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Papa Leo XIV nis sot vizitën në Francë, pritët nga qindra mijëra besimtarë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/25/papa-leo-xiv-nis-sot-viziten-ne-france-pritet-nga-qindra-mijera-besimtare/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 05:23:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	25 shtator 2026, 05:20:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 25 shtator 2026, 05:19:00 UTC → 25 shtator 2026, 05:21:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0d1730e63a56f3f5e1ab507fb0c443577fd47defb5d4d2d78724dff72630d97a
TEKSTI	3c9b94a9c6df4975fb50e041886fbee852ca72cc8babb192ad4b935eaf21936b
PAMJA	59fae6b0527b01c33d4a60d9cf65b548c633b9dbd47594ad39004853b6266a0d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0494532f58fa0a828623de3ad8d5af5ca3ea28df8546380f1678dd33f4b6e9e0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1b390a9b60bc15d034d856ca68f8d2f1d1d714d9e97cf6654bae7df19d1e6afd
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0494532f58fa0a828623de3ad8d5af5ca3ea28df8546380f1678dd33f4b6e9e0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA KRYESORE TË FUNDIT

Papa Leo XIV nis sot vizitën në Francë, pritët nga qindra mijëra besimtarë

25/09/2026 07:20



Papa Leo XIV nis të premten një vizitë katërditore në Francë, në udhëtimin e tij të parë në këtë vend si kreu i Kishës Katolike. Momenti kulmor pritët të jetë mesha madhështore në qendër të Parisit, ku autoritetet presin më shumë se gjysmë milioni besimtarë.

Për meshën e së shtunës pasdite, në Place de la Concorde është ngritur një altar, ndërsa një pjesë e madhe e zonës përreth Champs-Élysées do të jetë e rrethuar dhe e kontrolluar nga policia.

Rreth 600 mijë besimtarë pritët të mbushin bulevardin deri në Harkun e Triumfit dhe zonat përreth, ndërsa turma të mëdha priten edhe në ndalesat e tjera të vizitës së Papës.

Kisha Katolike e lidh këtë interes me një rritje të etjes shpirtërore mes francezëve dhe evropianëve, pavarësisht procesit të gjatë të sekularizimit të shoqërisë franceze.

Macron do ta presë Papën, por nuk do të marrë pjesë në meshë

Presidenti francez Emmanuel Macron do ta presë Papa Leo XIV në aeroportin Orly të premten në mëngjes. Më pas, dy liderët do të zhvillojnë bisedime në Pallatin Élysée, ku pritët të diskutojnë çështje gjeopolitike dhe inteligjencën artificiale.

Macron dhe Papa Leo XIV do të mbajnë gjithashtu një fjalim të përbashkët gjatë vizitës në Metz.

Megjithatë, presidenti francez nuk do të marrë pjesë në meshët e Papës, në respekt të parimit të ndarjes së shtetit nga feja, një parim veçanërisht i rëndësishëm në Francë.

Në meshën e së shtunës në Champs-Élysées pritët të marrin pjesë bashkëshortja e Macron, Brigitte Macron, si dhe kryeministri Sébastien Lecornu.

Në mesin e të pranishmëve priten edhe disa prej figurave politike që mund të garojnë në zgjedhjet presidenciale të vitit të ardhshëm, mes tyre Marine Le Pen, Édouard Philippe, Gabriel Attal dhe Bruno Retailleau.

Tensione për organizimin e vizitës

Para vizitës u raportua për disa mosmarrëveshje mes presidencës franceze dhe ekipit të Vatikanit që po koordinonte programin.

Sipas raportimeve, Macron kishte kërkuar një aspekt më ceremonial të vizitës, ndërsa zyrtarët e Élysée-së i kanë mohuar këto tensione.

Ata kanë sqaruar se është normale që një kreu shteti që viziton Francën, status që i atribuohet edhe Papës, t'i ofrohet një sërë ceremonish zyrtare, përfshirë edhe një

Kryesore



Top Story/ "Kërkoj ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK

21:21

Përshkallëzohet protesta pranë Kuvendit, përplasje mes Policisë dhe protestuesve, tentohet çarja e kordonit

12:54

"Shkova në shtëpi dhe mora thikën"/ Detaje nga vrasja e djeshme në Tiranë, dëshmia e autorit Toni Nake: Cara më bullizonte në mënyrë të vazhdueshme

09:43

Nga bllokimi i rrugës me kamionë, tek tërheqja në male, si ndodhi sulmi i Banjskës

13:23

Franca humbet Konate, Zidane e zëvendëson me futbollistin e skuadrës transalpine U21

13:01

Më të lexuarat

"Takime me agjentët serbë në dhomat e hotel 'Rogner'"/ AGSH reagon për deklaratën e Vlora Hysenit: Shantazh ndaj gazetares. Reagon dhe Klodiana Lala

Aksion i policisë në Tiranë, vihen në pranga 8 të kërkuar për krime të rënda, armë, drogë dhe vjedhje

Top Story/ "Kërkoj ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK

"Dumani përzuri Vlorën nga zyra", Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025

"Për ty fik radarët e shtetit"/ Komunikimet Hyseni-Agasi, deputetët e opozitës zbulojnë mesazhet: I thoshte që çunat të veprojnë lirshëm

Masa ndaj Vlora Hysenit, Kryemadhi batuta me gazetarët para gjykatës: I patë si i fik radarët? Dashuria, gjë e madhe

VIDEO/ Ish-kreu i SHISH, Vlora Hyseni del nga GJKKO, iu komunikua masa e sigurisë "arrest në shtëpi". Nuk flet për mediat

"Goca dhe Gra" rikthehet në ekranin e Top Channel me ndryshime, kush janë moderatorët e sezonit të ri?

eskorte karobesie përgjate Champs-Élysées. Megjithatë, sipas tyre, nuk ishte e pritshme që Papa të pranonte domosdoshmërisht të gjitha propozimet.

Vatikani konfirmoi gjithashtu se Papa Leo XIV nuk e pranoi një propozim të Macron për t'u takuar me artizanët që morën pjesë në rindërtimin e Notre-Dame, pas zjarrit shkatërrues të vitit 2019. Arsyeja e dhënë ishte programi i ngjeshur i vizitës.

Nga Notre-Dame te Stade de France

Pas një udhëtimi me Papamobil mes turmave, Papa Leo XIV do të vizitojë të premten pasdite katedralen Notre-Dame.

Në mbrëmje ai do të takohet me rreth 80 mijë të rinj në Stade de France, në veri të Parisit.

Të dielën, Papa do të udhëtojë drejt Lourdes, një prej vendeve më të rëndësishme të pelegrinazhit katolik në botë. Rreth 150 mijë persona janë regjistruar për meshën që do të zhvillohet atje.

Gjatë vizitës në Lourdes, Papa do të takohet gjithashtu me disa persona që kanë deklaruar se janë viktime të abuzimeve seksuale nga pjesëtarë të klerit katolik.

Të hënën, vizita do të vijojë në Metz, në verilindje të Francës, ku Leo XIV do të nderojë Robert Schuman, një prej figurave themeluese të Bashkimit Evropian dhe një katolik i devotshëm, i cili aktualisht është kandidat për lumturim.

Papa do të takohet gjithashtu me një grup emigrantësh gjatë qëndrimit në Francë.

Papa me rrënjë franceze

Papa Leo XIV, i lindur në Çikago në vitin 1955 me emrin Robert Prevost, ka edhe lidhje familjare me Francën.

Gjyshja e tij nga babai kishte lindur në Le Havre, në Normandi, në vitin 1894. Më vonë, pasi u martua në Shtetet e Bashkuara me një burrë me origjinë italiane, familja mori mbiemrin Prevost, i cili ishte mbiemri i vajzërisë së nënës së saj.

Franca dhe Kisha Katolike, një marrëdhënie me histori të gjatë

Franca ka një marrëdhënie historikisht komplekse me Kishën Katolike dhe Selinë e Shenjtë.

Për shekuj me radhë, vendi është konsideruar si "vajza e madhe e Kishës", edhe pse pretendimi se Franca ishte mbretëria e parë që u konvertua në krishterim nuk është historikisht i saktë. Armenia, Gjeorgjia dhe Etiopia u konvertuan më herët.

Në shekullin XIV, papati u zhvendos për një periudhë në Avignon, në jug të Francës. Në shekujt pasues, ushtritë franceze ndërhyjnë në mënyrë periodike në politikën italiane, në një kohë kur papët ishin jo vetëm udhëheqës fetarë, por edhe sundimtarë territorialë.

Edhe Napoleon Bonaparti mbajti dy papë në arrest.

Papët e fundit kanë vizituar Francën. Papa Gjon Pali II e vizitoi vendin disa herë, nga viti 1980 deri në vitin 2004. Ndërsa Papa Françesku e vizitoi Francën tri herë, por nuk zhvilloi vizitë në Paris, duke zgjedhur Strasburgun, Marsejën dhe Korsikën.

Interesi për fenë po shfaq shenja rikthimi

Franca e sotme është një shoqëri shumë më laike se në të kaluarën. Më pak se gjysma e popullsisë identifikohet si katolike.

Numri i personave që marrin pjesë rregullisht në shërbesat fetare ka rënë ndjeshëm: nga rreth 35% e popullsisë në vitin 1960, në më pak se 5% sot. Ndërkohë, numri i priftërinjve ka rënë me rreth dy të tretat, nga 25 mijë në vitin 1990 në më pak se 9 mijë.

Megjithatë, vitet e fundit janë shfaqur disa shenja të një interesi në rritje për traditat fetare. Numri i të rriturve që pagëzohen është më shumë se dyfishuar brenda pesë vitesh, duke arritur në rreth 10 mijë në vitin 2025.

"Franca është sekularizuar, por ekziston një boshllëk aty ku dikur ishin Zoti dhe vlerat", tha kardinali François Bustillo, peshkop i Ajacios.

Sipas tij, shumë njerëz po kërkojnë diçka shpirtërore dhe po eksplorojnë tradita të ndryshme fetare në botë.

Bllokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali

"Po si nuk i fiku njeri radarët për mua moj motër", Kryemadhi batuta dhe ironi për Vlora Hysenin: Meta i ndizte se kishte hallin e vendit, puthte...

"Tani Papa vjen nga Roma, duke u kujtuar njerëzve rrënjët e tyre", u shpreh ai, duke shtuar: "Gjon Pali II zgjoi Lindjen. Tani Leo XIV do të zgjojë Perëndimin."

Top Channel

I Bota »



Shqipëria amerikane për Xi dhe mesazhe për Tajvanin, çfarë ndodhi në takim me Trump dhe liderit suprem të Kinës

25/09 07:14



Fjalimi i Netanyahu në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, dhjetëra diplomatë lënë sallën: Nëse ka frikacakë të tjerë të largohen tani

24/09 22:59



"I mbani mend këto?"/ Netanyahu tregon gjatë fjalimit në OKB bombat me të cilat u eliminua udhëheqja e Hezbollahut: Menduan se u rrëzuam kur na sulmuan

24/09 22:45



Aksident i rëndë në Rumani, dy gra nga Mbretëria e Bashkuar humbin jetën pasi furgoni i tyre shtypet nga dy kamionë

24/09 20:46



Problemi me emigracionin në Mbretërinë e Bashkuar/ Home Office regjistron 781 hyrje në një ditë, numri më i lartë gjatë 2026-ës

24/09 20:22



Lukashenko fal 15 të burgosur politik, lëshon dekreten pas negociatave me përfaqësuesin e Trump

24/09 18:55

I Kryesore »



Shqipëria amerikane për Xi dhe mesazhe për Tajvanin, çfarë ndodhi në takim me Trump dhe liderit suprem të Kinës

25/09 07:14



Parashikimi i motit/ Dita e sotme sjell reshje, shtrëngata dhe dëborë në zonat malore

25/09 07:05



"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

25/09 01:12



Top Story/ "Hakmarrja është intimidimi i Klodiana Lalës", Murrizi për Vlora Hysenit: Ajo e di kush ka hyrë e kush ka dalë nga zyra e Agasit

24/09 22:53



Top Story/ "Mbrotja do jetë arrogante", Vangjeli për deklaratën e Vlora Hysenit: Po shantazhon njerëzit me pushtet. Pretendimi i saj për Agasin, i gënjeshtër

24/09 22:50



"I mbani mend këto?"/ Netanyahu tregon gjatë fjalimit në OKB bombat me të cilat u eliminua udhëheqja e Hezbollahut: Menduan se u rrëzuam kur na sulmuan

24/09 22:45

Na ndiqni:



I Video »





"Agjente serbe! Të neveris!",
Plas mes Vlora Hysenit dhe
Klod Lalës! Dalim video dhe
përgjime të reja



Top Channel/ Protesta e 117,
organizatorët: tubim në çdo
seancë parlamenti



Top Channel/ Revolta ndaj
Netanyahut, braktiset salla dhe
arrestohen 100 persona



Top Channel/ Alarmi i
shërbimeve sekrete: Rusia do
sulmojë një vend të NATO-s



Top Channel/ Melania "kunja"
për Trump: unë kam jetuar mirë
në komunizëm



Top News- Sulmi i ashpër i
Netanyahut kundër Erdoganit:
Është tiran, po kërcënon
Greqinë, por ne...

Lajme	Bota	Sport	Pop News	Programe	Top Channel
Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Për'puthen	Kontakt
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Bileta – Portokalli
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.